



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), neneve 10, 17 par.4 dhe 5 si dhe 19 par.1 dhe 7 LIGJI Nr. 06/L-012 PËR KRYEQYTETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PRISHTINËN, nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit Komunal më datë: 13.12.2024 merr:

V E N D I M
për

Kompensimin Vjetor për Financimin e Ushqimit për Punëtorët e Administratës së Kryeqytetit

Neni 1

1. Miratohet Kërkesa për Kompensimin Vjetor për Financimin e Ushqimit për Punëtorët e Administratës së Kryeqytetit.

Neni 2

2. Shuma e realizuar për Kompensimin Vjetor për Financimin e Ushqimit për Punëtorët e Administratës së Kryeqytetit është në vlerë prej: 1.370.00 € bruto (1200 euro neto).

Neni 3

3. Shuma e realizuar për Kompensimin Vjetor për Financimin e Ushqimit për Punëtorët e Administratës së Kryeqytetit sipas nenit 2, realizohet përmes burimeve financiare të përcaktuara në dispozitat e LIGJIT Nr. 06/L-012 PËR KRYEQYTETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PRISHTINËN.

Neni 4

4. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Kryeqytetit dhe Drejtoria për Financa.

Neni 5

5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës së Kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-165425/24, më 16.12.2024

Kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit
Fehmi Kupina

